

ARGUMENTUM

news opinion analysis



Pse kryeministri i parë shqiptar i qeverisë teknike në RMV nuk është ngjarje historike?

- Marrëdhëniet Shqipëri-Turqi mes gjeopolitikës dhe fesë.
- Presidenca belge e BE-së në kriza dhe konflikte!
- "Ballkani i Hapur" ende frymon.

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- Pse kryeministri i parë shqiptar i qeverisë teknike në RMV nuk është ngjarje historike?

06 POLITIKË

- “Ballkani i Hapur” ende frymon/ Firmoset marrëveshja mes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë!
- Presidenti Begaj pret Ministrin e Jashtëm të Turqisë: Marrëdhëniet shqiptaroturke, të një rëndësie strategjike

08 OP/ED

- ZGJEDHJET NË TAJVAN dhe ndikimi i tyre në marrëdhënie me Kinën dhe stabilitetin global
Shqipëri, Rajon dhe Botë.

11 JO VETEM LAJM

- Gjykata Kushtetuese miraton marrëveshjen e emigrantëve me Italinë
- Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë pret Ambasadorin e re të RP të Kinës në Shqipëri

12 FOKUS

- Marrëdhëniet Shqipëri-Turqi mes gjeopolitikës dhe fesë
- Çështja Beleri arrin në Parlamentin Evropian

15 REALPOLITIK

- Presidenca belge e BE-së në kriza dhe konflikte! Europës i mungon Delori! Tur i mirëpritur rajonal! Ftohtë jashtë, nxehtë brenda!

18 BOTA

- Në vitin 2024, politika e brendshme e SHBA-së do të hedhë një hije të errët në të gjithë botën

ENGLISH EDITION

21 ENGLISH TOP NEWS

- Foreign Ministry: Albania successfully completed screening process in 2023

22 IN FOCUS

- Kosovo and Serbia take a small but important step forwards

24 BALKAN OVERVIEW

- ‘Kosovo deserves stability, security and prosperity,’ says David Cameron.

25 REALPOLITIK

- EU Belgian Presidency of crises and conflicts! Europe misses Delors! A welcome regional tour! Ice-cold inside, politically hot inside Davios!

28 REALPOLITIK

- Bosnia ‘on brink of collapse’ as EU watches on

29 BALKAN OVERVIEW

- O’Brien: We will not allow a repeat of Banjska

29 GLOBAL

THE YEAR AHEAD



Pse kryeministri i parë shqiptar i qeverisë teknike në RMV nuk është ngjarje historike?

Talat Xhaferi, ish-kryetari i Kuvendit maqedonas është zgjedhur kryeministër i Qeverisë teknike të Maqedonisë së Veriut më 28 Janar 2024.

Talat Xhaferi, u zgjodh kryeministër i Maqedonisë së Veriut me 65 vota pro dhe 3 kundër, duke hyrë në histori si i pari shqiptar që do të drejtojë qeverinë e vendit fqinjë, megjithëse me një mandat të përkohshëm prej 100 ditësh. Qeveria teknike do të ketë si detyrë mbarëvajtjen e zgjedhjeve parlamentare të 8 Majit.

Përfaqësuesit e opozitës maqedonase të VMRO DPMNE, edhe pse të pranishëm në sallën e Kuvendit nuk morën pjesë në votim, pasi ishin kundër qeverisë teknike që do dre-

jtojë Xhaferi.

Ndërsa lideri i BDI-së, Ali Ahmeti e ka cilësuar këtë ditë si historike.

“Kjo ditë është historike sa për shqiptarët, aq edhe për maqedonasit, si dhe për të gjithë të tjerët. Bashkarisht po ndërmarrim përgjegjësinë për t’i prirë vendit, jo njëri pas tjetrit, por krah më krah, bashkë, për një Maqedoni Europiane”, tha ai gjatë një video-mesazhi të shtunën e 27 Janarit.

Kujtojmë se partia “Bashkimi Demokratik për Integritim”, (BDI), është një parti e dalë nga lufta e vitit 2001, ku shtylla e saj kryesore ishte faktorizimi i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, por përgjatë 23 viteve, është faktorizuar vetëm ajo si parti politike.

Në emër të shqiptarëve dhe për shqiptarët, kryetari i kësaj partie, Ali Ahmeti ka qenë gjithmonë me pushtetin, herë me VMRO-DPMNE dhe herë me LSDM-në, ndërsa ka luajtur me karten nacionaliste duke garantuar një karrige të përhershme në parlamentin maqedon.

Edhe në zgjedhjet e vitit 2020, i gjendur në pikën më të ulët përballë elektoratit shqiptarë "Asi" nën mënge i Ali Ahmetit ishte "Koha për Kryeministër Shqiptar". Duke përdorur edhe njëherë karten nacionaliste ai siguroi një tjetër mandat bashkëqeverisës.

Ndërsa shqiptarëve u tha se e mbajti premtimin pasi nga BDI do të kishim zv/kryeministrin e parë shqiptar, i cili më shumë mburret për postin e tij herë si zëvendës i Zaevit e herë si zëvendës i Kovacevskit se sa për angazhime konkrete për qytetarët e Maqedonisë së Veriut.

Ali Ahmeti dhe partia e tij BDI, prej 23 vitesh marrin çdo atribut në Maqedoni duke monopolizuar çdo arritje në vend, sidomos përballë shqiptarëve.

"Ne kemi vendosur barazi përmes zbatimit të plotë të Marrëveshjes së paqes të Ohrit, legalizimit të arsimit të lartë në gjuhën shqipe, decentralizimit, simboleve dhe kulturës kombëtare, gjuhës shqipe, përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, integritit në NATO, duke marrë dritën jeshile për anëtarësimin në BE", deklaroi të shtunën kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti.

Këto arritje padiskutim nuk i atribuohen vetëm BDI-së por të gjithë faktorit shqiptarë në Maqedoninë e Veriut politik dhe jo politik, por dhe falë faktorit maqedonas. Ndërsa përfituesi kryesor mbetet vetë Ali Ahmeti dhe Partia e tij.

BDI-ja kjo forcë politike e lindur pas luftës ndëretnike të vitit 2001, mes shqiptarëve dhe maqedonasve, pikërisht në sajë të një urrejtje etnike ndërmjet tyre, duket se ende mban ndezur pishtarin e nacionalizmit, pasi kjo parti, edhe në emrin e Demokracisë nuk arriti të zhbëjë hijen e nacionalizmit, duke u shndërruar pikërisht në një parti nacionaliste.

Diskursi politik "ne shqiptarët, ata maqedonasit", krijon një hendek të madh në këtë vend, e për pasojë bën që të zgjohen reminishencat nacionaliste të së kaluarës, sikundër për fat të keq i pamë këto ditë, ndërsa u betua kryeministri i parë shqiptar dhe qeveria teknike nën drejtimin e tij.

Zgjedhjen e kryeministrit të parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut, që Ali Ahmeti e quan si ngjarje historike, në fakt rrjedh nga Marrëveshja e njohur si e "Përzhinës", të arritur në vitin 2015, për zgjidhjen e krizës së atëhershme politike në vend. Sipas marrëveshjes, Qeveria jep dorëheqje 100 ditë para ditës së zgjedhjeve duke i hapur rrugë qeverisë teknike.

KUSH ËSHTË TALAT XHAFERI?

Teksa shqiptarët me në krye Ali Ahmetin kishin filluar luftën, Xhaferi ishte ende një oficer në ushtrinë maqedonase si komandant në Tetovë. Por një masakër e 28 prillit 2001, që njihet si masakra e Vicës, bëri



që vetëm disa ditë më vonë Xhaferi të braktiste radhët e Armatës së Maqedonisë dhe kaloi në radhët e UÇK-së. Ai në këtë periudhë u njoh me nofkën komandant Forina, duke marrë emrin e fshatit të lindjes. Që prej atëherë deri në përfundim të luftës Xhaferi u bë komandanti i Brigadës 116.

Talat Xhaferri, apo dhe partia ku ai aderonte, me në krye kryetarin e përjetshëm Ali Ahmeti, prej më shumë se dy dekadash e kanë udhëhequr Maqedoninë e Veriut. Ndaj zgjedhja e tij si kryeministër nuk përbën asnjë tabu për qytetarët maqedonas. Kështu nëse shohim në retrospektivë, pas marrëveshjes së Ohrit dhe fundit të luftës, Talat Xhaferi u zgjodh deputet për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2002 nga radhët e Bashkimit Demokrat për Integrit të Ali Ahmetit. Nga viti 2004-2006 Xhaferi ishte Zëvendës Ministër i Mbrojtjes, ndërsa nga viti 2008 deri në vitin 2013 u rizgjodh deputet.

Në vitin 2013 Xhaferi u emërua nga BDI si Ministër i Mbrojtjes. 4 vite më vonë, në prill të vitit 2017, ai u bë kryetari i parti shqiptar i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, ku mbajti këtë post deri më 28 Janar 2024, ku mori drejtimin e qeverisë teknike si kryeministër i saj.

Nxitimi për ta quajtur këtë ngjarje, si një moment historik, ndonëse pa asnjë rezultat të prekshëm të vete popullsisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut, ka vetëm një synim, atë të përthithjes edhe një herë të votës së elektoratit shqiptar.

Pra, Ali Ahmeti synon të fitojë sërish mazhorancën e votës së shqiptarëve, pas 20 viteve, duke mbetur si shqiptari më jetëgjatë në pushtet me të dyja forcat politike maqedonase.

Sot falë Ali Ahmetit dhe propagandës së tij politiko-nacionaliste jemi larg asaj dite, ku shqiptarë e maqedonas ta shohin vetën të barabartë si qytetarë të Maqedonisë së Veriut.

Historike do të jetë dita kur kryeministri shqiptar të zgjidhet me votë popullore nga shumica e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut pa marrë parasysh përkatësinë etnike të tyre.

Dispozitat e Marrëveshjes së Perzhinos janë pjesë e Ligjit për Qeverinë, ku ndër të tjera janë paraparë disa pozita ministore dhe zv/ministore për opozitën.

Marrëveshja e Përzhinos thekson qartë kompetencat e Qeverisë teknike dhe ajo nuk mund të bëjë asgjë tjetër përveçse të përgatisë teknikisht zgjedhjet.

Në fakt, vetë marrëveshja e Perzhinos e minon Demokracinë në vend.

E detyruar të zbatohet në një kohë të errët për Maqedoninë e Veriut, çuditërisht ende vijon të zbatohet sa herë ka zgjedhje elektorale.

Sot, ndërsa Maqedonia e Veriut është anëtare e Nato-s dhe prej vitit 2022 janë hapur negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Europian, është e papranueshme që të ekzistojë kjo qeveri teknike, e cila minon vetë Demokracinë e vendit.

Megjithatë, Ali Ahmeti, ende e përdor këtë element të kësaj marrëveshje si premtim elektoral për shqiptarët, duke u ofruar një karrige bosh.

Edhe për zgjedhjet parlamentare në Maqedoninë e Veriut që do të mbahen më 8 maj ai ka thënë se “është koha që qeveria të mandatohet me një kryeministër shqiptar”, duke vijuar me të njëjtin premtim si ajo e katër viteve më parë.

Si u premtua kryeministri i parë shqiptar?

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, Bashkimi Demokratik për Integrim që drejtohet nga Ali Ahmeti garoi me sloganin “Për kryeministrin e parë shqiptar”, ndërsa kandidat të saj kishte juristin dhe ish-politikanin Naser Ziberi.

Meqë zgjedhjet ishin fituar nga Lidhja Social Demokrate, kryeministër ishte zgjedhur Zoran Zaev, që atëkohë drejtonte LSDM-në.

Por, për të përmbushur premtimin e BDI-së, Zoran Zaev dhe Ali Ahmeti në marrëveshjen për bashkëqeverisje ishin pajtuar që në 100 ditët e fundit të punës së Qeverisë, kryeministër të caktohet një kandidat i propozuar nga Bashkimi Demokratik për Integrim.

Bëhet fjalë për Qeverinë teknike, e cila parashihet me Ligjin për zgjedhjet dhe si detyrë kryesore ka organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve, ndërsa pjesë e saj do të jetë edhe opozita maqedonase me dy ministra dhe tri poste të zëvendësministrave.

“Një kryeministër me kapacitet të cunuar, që do të thotë se ajo qeveri nuk është politike por teknike. Pra, kapaciteti i saj është i reduktuar dhe kjo lë për të dëshiruar. Nuk është kryeministër me kapacitet të plotë”, thotë Naser Ziberi, ish-kandidat për kryeministër nga radhët e BDI-së në zgjedhjet e vitit 2020. Por, pavarësisht kësaj, BDI-ja në të gjitha paraqitjet

publike caktimin e Talat Xhaferit për kandidat për kryeministër të Qeverisë teknike, e ka vlerësuar si një nga “arritjet më të mëdha”, pas kryetarit shqiptar të Kuvendit, që ishte po Talat Xhaferi, por edhe ministrave shqiptarë të Punëve të Brendshme, Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme.

Ajo që duhet të ishte thjesht një marrëveshje stabilizuese afatshkurtër, u përdor gjerësisht nga BDI si i vetmi mjet për të arritur qëllimin e tij... të sigurojë pushtetin krah për krah me qeverinë në Maqedoninë e Veriut pa marrë parasysht nëse është LSDM-ja apo VMRO-DPMNE

Shqiptarët dhe maqedonasit i kanë thënë JO ndasive etnike

Që prej konfliktit të armatosur midis forcave të sigurisë dhe shqiptarëve në vitin 2001 me humbje të mëdha në njerëz si nga pala shqiptare dhe ajo maqedonase, dhe duke parë në vijimësi marrëdhëniet politike, qytetarët shqiptarë dhe maqedonas, i janë shmangur përplasjes etnike në dy episode të përgjakshme në Maqedoninë e Veriut e nxitur po si pasojë e krizës politike në vend.

Risjellim në kujtesë, krizen politike të 2015 dhe rasti i Kumanovës.

Përleshja e armatosur midis shqiptarësh etnikë të armatosur dhe policisë maqedonase që la 18 të vdekur, risjell në mendje kujtimet e trazirave të kaluara. Fakti që as popullsia shqiptare, e as ajo maqedonase nuk iu përgjigj propagandës për të luftuar kundër njëri-tjetrit, tregon se karta e nacionalizmit është djegur në këtë vend.

Po ashtu, dhe ngjarjet e 27 prillit 2017 në parlamentin e Maqedonisë së Veriut, ku në ambientet e brendshme të Kuvendit i nxitur nga kandidimi dhe zgjedhja e politikanit shqiptar, Talat Xhaferri, në krye të parlamentit, la të plagosur disa persona, mes tyre kryetarin Zijadin Sela të Aleancës për Shqiptarët dhe kryeministrin e asaj kohe, Zoran Zaev, hasi në indiferencën e shumicës së popullsisë që nuk iu bashkua as protestave e as këtyre përplasjeve kundër njëri-tjetrit.

Këto dy raste flagrante përpos situatës tejte të rrezikshme, që nuk arritën të ndiznin armiqësi më të mëdha të motivuara etnikisht, tregon se shoqëria shqiptaro-maqedonase kërkon pajtim dhe jo ndasi etnike. Të njëjtën gjë duhet të bëjnë gjithashtu politikanët e të dyja palëve politike, qofshin maqedonas apo shqiptare, që të ulin dozat e nacionalitetit dhe të shpalosin, programe konkrete për mirëqenien e secilit qytetarë që jeton brenda territorit të RMV-së pa marrë parasysht përkatësinë etnike apo fetare.

“BALLKANI I HAPUR” ENDE FRYMON

Firmoset marrëveshja mes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë!

Qeveritë e Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut kanë firmosur një marrëveshje që mundëson lëvizjen e lirë të punëtorëve mes 3 vende duke nisur nga data 1 mars. Detajet e marrëveshjes së dakordësuar më herët, u finalizuan ditën e djeshme gjatë samitit në Shkup mes liderëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe zyrtarëve të BE për rritjen ekonomike të rajonit, duke treguar fare qarte se nisma “Ballkani i Hapur” vazhdon ende.

Protokolli i nënshkruar ka të bëjë me zbatimin e marrëveshjes dhe kushteve të saj për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor. Ndërsa pika tjetër e marrëveshjes ka të bëjë me skemën elektronike për identifikimin e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor, me kartë elektronike.

“Kemi pasur disa gjëra të rëndësishme, gjithmonë ka detaje të pakëndshme, por nuk dua të flas për këtë. Dhe këtë e kemi pritur me muaj të tërë, që do të thotë se nga 1 marsi më në fund duhet të hyjë në fuqi ajo për të cilën folëm, që është një treg krejtësisht i lirë i punës në vendet e Ballkanit të Hapur – Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë është një lajm i madh dhe i rëndësishëm dhe mendoj se do të kontribuojë shumë në krijimin e një ambienti më të mirë biznesi për kompanitë vendase dhe të huaja,



për të kapërcyer problemin me mungesën e fuqisë punëtore dhe për krijimin e një tregu pune që është jo më gjashtë apo shtatë milionë banorë, por nëse shtoni Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, ne po i afrohem 11 milionë banorëve”, -tha Vuçiç. Kujtojmë që kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në deklaratimet e tij të bëra gjatë vitit

të kaluar, kishte lënë të kuptohet se gjithçka rreth Ballkanit të Hapur kishte marrë fund. Në korrik të vitit 2023, Rama deklaroi se nisma “Ballkani i Hapur” kishte dhënë rezultatet e tij dhe se tashmë duhej fokusuar në Procesin e Berlinit. Por mesa duket Vuçiç nuk e lejon më të tërhiqet nga nisma e ‘Ballkanit të Hapur’, ndaj dhe kjo nisme ende frymon.



Presidenti Begaj pret Ministrin e Jashtëm të Turqisë: Marrëdhëniet shqiptaro-turke, të një rëndësie strategjike

Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Bajram Begaj, priti sot Ministrin e Jashtëm të Republikës së Turqisë, Sh. T. Z. Hakan Fidan.

Kreu i Shtetit bisedoi me kryediplomatën turke për marrëdhëniet mes dy shteteve dhe zhvillimet rajonale.

Presidenti Begaj vlerësoi se Shqipëria dhe Turqia janë partnerë strategjike dhe kanë një miqësi tradicionalisht shumë të mirë.

“Bashkëpunimi shqiptaro-turk, në të gjitha fushat, është një bashkëpunim i frytshëm, – u shpreh ai. Presidenti i përcolli Ministrin të Jashtëm Hakan Fidan falënderimet për ndihmën që Turqia i ofroi Shqipërisë në procesin e rindërtimit pas tërmetit, por edhe



për investimet e tjera në vendin tonë. Turqia është ndër partnerët ekonomikë më të mëdhenj në Shqipëri dhe investimet turke kanë të punësuar më shumë se 15 mijë shqiptarë në vendin tonë.

Për sa u përket zhvillimeve në Ballkan, Presidenti Begaj vlerësoi: “Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë shtylla të rëndësishme për politikën shqiptare, që garantojnë paqe, siguri, stabilitet demokratik në rajon, si dhe janë parakushte për integrimin e rajonit në Bashkimin Evropian”.

Presidenti e vlerësoi rolin dhe kontributin e Turqisë në Ballkanin Perëndimor si një partner i natyrshëm e historik për paqen dhe sigurinë e rajonit.

Gjithashtu, ai e vlerësoi mbështetjen që Turqia jep për integrimin e Kosovës në organizmat rajonale dhe globale, si dhe lobimet e saj të fuqishme për njohjen e mëtejshme të Kosovës.

ZGJEDHJET NË TAJVAN

dhe ndikimi i tyre në marrëdhënie me Kinën dhe stabilitetin global



MARJANA DODA

Duke parë kalendarin e ngjarjeve gjeopolitike të parashikuara që të zhvillohen përgjatë vitit 2024, data 13-Janar, shihet si një ngjarje nga e cila do të rrjedhin ndryshime të mëdha botë.

Të gjithë sytë janë te Tajvani, pasi ishulli vetëqeverisës me 23 milionë banorë iu drejtua qendrave të votimit të shtunën e 13 Janarit, ku rreth 19.5 milionë qytetarë votuan për të zgjedhur presidentin dhe legjislaturën e re.

Sigurisht ky ishull mori një vëmendje globale pasi këto zgjedhje mund të formësojnë marrëdhëniet si me Pekinin ashtu edhe me Uashingtonin, pasi Tajvani është një pikë kyçe e përplasjes e tyre në kontinent.

Zv.lideri i Tajvanit Lai Ching-te ishte kandidati që fitoi zgjedhjet të shtunën. Më 13 janar,

Lai Ching, kandidati i Partisë Demokratike Progresive (DPP) doli si fitues i zgjedhjeve të liderit të Tajvanit, duke mbledhur mbi 40% të mbështetjes nga votuesit. Ndërsa Hou Yu-ih, kandidati i opozitës Kuomintang (KMT) dhe kandidati i tij kandidat Jaw Shaw-kong morën 33.49 përqind të votës. Kandidati i partisë së tretë Ko Wen-je dhe kandidati i tij kandidat Wu Hsin-ying i Partisë Popullore të Tajvanit (TPP) morën 26.45 përqind të votave, sipas raporteve të mediave. Një fitore pa lavdi do ta quaja, duke marrë parasysh të gjitha pikëpyetjet që parashtrihen pas kësaj fitore për pasojat dhe për ndikimin që do të sjellë në rajon dhe botë.

Por çfarë do të thotë zgjedhja e kandidatit të Partisë Progresive Demokratike (DPP) Lai Ching-te për marrëdhëniet Tajvan-Kinë dhe stabilitetin global?

Fitorja presidenciale me përzg-

jedhjen e Lai Ching ne krye te saj, i ashtuquajtur si një “problem-bërës” që minon paqen dhe stabilitetin e ngushticës së Tajvanit duket se do të sjellin pasojat të mundshme rajonale dhe globale duke cënuar ndjeshëm përpjekjet diplomatike, stabilitetin ekonomik dhe potencialin për konflikt të gjithanshëm me Kinën.

Duke parë në retrospektive, e gjithë retorika e tij politike mbështetet te statusi i Tajvanit.

Statusi i Tajvanit për Lai është se “Tajvani është tashmë një vend sovran dhe i pavarur i quajtur Republika e Kinës”. Për Kinën, kjo do të thotë se Lai ka anashkaluar të gjitha hapat për të ndjekur pavarësinë, sepse ai e sheh Tajvanin tashmë të pavarur.

Kina nuk reagoi ndaj deklaratës së tij gjatë sezonit zgjedhor me arsyetimin se 1) ai po fliste si kandidat dhe 2) çdo reagim i madh nga ana e Kinës do të rezultonte mbrapsht. Tani që ai është zgjed-

Kina nuk reagoi ndaj deklaratës së tij gjatë sezonit zgjedhor me arsyetimin se 1) ai po fliste si kandidat dhe 2) çdo reagim i madh nga ana e Kinës do të rezultonte mbrapsht. Tani që ai është zgjedhur, përsëritja e këtij pozicioni apo ndermarrja e cdo hapi drej kësaj teorie që Lai pretendon, do të shkaktojë një tronditje të thellë politiko-diplomatike, në kontinentin aziatik dhe në bote.

hur, përsëritja e këtij pozicioni apo ndermarrja e çdo hapi drej kësaj teorie që Lai pretendon, do të shkaktojë një tronditje të thelle politiko-diplomatike, në kontinentin aziatik dhe në botë.

Në 18 gusht, Lai Ching-te, zëvendëslieri i rajonit të Tajvanit të Kinës, u kthye në Tajvan pasi mbaroi “tranzitin” e tij në SHBA. Para dhe pasi ai të ikte në SHBA, tajvanezët dhe emigrantët kinezë në SHBA protestuan duke hedhur parulla të tilla si “Kundër pavarësisë së Tajvanit” dhe “Pavarësia e Tajvanit është një rrugë pa krye”. Këtë herë edhe pala amerikane bëri një “trajtim të ftohtë” ndaj Lait. Këto konfirmojnë se të gjitha palët pranojnë se Lai Ching-te është një “problembërës” i plotë.

Tani, shumë njerëz po flasin për një “status quo” të çështjes së ngushticës së Tajvanit. Pra, çfarë është “situata e tanishme”? Faktet janë të qarta, pra Tajvani është pjesë e territorit të Kinës. Megjithatë ka pasur dallime politike afatgjata midis dy anëve të ngushticës, sovraniteti kombëtar dhe integriteti territorial i Kinës nuk janë ndarë kurrë.

Për një kohë të gjatë, Lai Ching-te e ka quajtur veten një “punëtor pragmatik për pavarësinë e Tajvanit”. Vitet e fundit, ai shpesh ka mbrojtur “pavarësinë e Tajvanit” dhe ka nxitur “urrejtje dhe rezistencë ndaj Kinës”. Pasi u emërua nga Partia Demokratike Progresive këtë vit për të kandiduar si lideri i rajonit të Tajvanit në vitin 2024, ai ndryshoi të ashtuquajturën tezë “mbrojmë Tajvanin përmes kundërshtimit ndaj Kinës” në “mbrojmë paqen e Tajvanit” nga nevojat e strategjisë zgjedhore.

“Gjithnjë e më shumë njerëz në Tajvan e kuptojnë se “pavarësia



e Tajvanit” është e papajtueshme me paqen dhe stabilitetin e ngushticës së Tajvanit dhe bindesh me interesat dhe mirëqenien e bashkatdhetarëve në të dy anët e ngushticës. Kundërshtimi me vendosmëri i “pavarësisë së Tajvanit” dhe ndjekja e përbashkët e ribashkimit paqësor janë në interesin më të mirë të popullit kinez në të dy anët e ngushticës. Kontinenti është i gatshëm të krijojë një hapësirë të gjerë për ribashkim paqësor, por kurrë nuk do lejojë asnjë hapësirë për “pavarësinë e Tajvanit” me forma të ndryshme”, është theksuar nga pala kineze.

Çfarë lidhje ka SHBA-ja me marrëdhëniet Kinë-Tajvan?

SHBA mban lidhje zyrtare me Pekinin dhe e njeh atë si të vetmen qeveri kineze sipas “politikës së saj të Kinës” – por gjithashtu mbetet mbështetësi më i rëndësishëm ndërkombëtar i Tajvanit. Ndërkohë, tensionet SHBA-Kinë janë zbutur pak pas Samitit Biden-Xi të nëntorit, i projektuar për të vendosur një dysheme nën marrëdhëniet deri në vitin 2024. Biden ripohoi politikën “Një-Kinë” të Shteteve të Bashkuara bazuar në tre komunika-

ta themelore dhe Aktin e Marrëdhënieve me Tajvanin e vitit 1979. Mbështetja në rritje për armatosjen dhe mbrojtjen e Tajvanit në Kongres, vizitat e nivelit të lartë, ndihma ushtarake e shtuar dhe legjislacioni në pritje që thellon lidhjet SHBA-Tajvan, kanë ngritur frikën në Pekin se Biden po ndjek një politikë “Një-Kinë, Një-Tajvan”.

Gjatë takimit të tij me homologun amerikan në nëntorin e vjetshëm në San Francisko, presidenti kinez vuri në dukje se, problemi i Tajvanit mbetet çështja më e rëndësishme dhe më e ndjeshme në marrëdhëniet kino-amerikane. Kina i merr seriozisht deklaratat pozitive të bëra nga Shtetet e Bashkuara në takimin e Balit. SHBA-ja duhet të ndër marrë veprime konkrete për të mbajtur premtimin e saj se nuk do të përkrahë “pavarësinë e Tajvanit”, do të ndalojë armatimin e Tajvanit dhe do të mbështesë ribashkimin paqësor të Kinës.

Presidenti Xi vuri në dukje se respekti i ndërsjellë, bashkëjetesa paqësore dhe bashkëpunimi me leverdi të ndërsjellë janë mësimet e nxjerra nga marrëdhëniet 50-vjeçare kino-amerikane, si edhe nga konfliktet midis ven-

deve të mëdha përgjatë historisë. Kina dhe SHBA-ja duhet të bëjnë më shumë përpjekje për t'iu përmbajtur këtyre mësimëve. Për sa kohë që këto dy vende të mëdha respektojnë njëri-tjetrin, bashkëjetojnë në paqe dhe zbatojnë bashkëpunimin me leverdi të ndërsjellë, ato do të jenë plotësisht të aftë të ngrihen mbi dallimet dhe të gjejnë rrugën e duhur që të shkojnë mirë me njëri-tjetrin. Në Bali vitin e kaluar, pala amerikane deklaroi se nuk kërkon të ndryshojë sistemin e Kinës, as të nisë një Luftë të Ftohtë të re, apo të rigjallërojë aleancat e saj kundër Kinës, duke mos mbështetur “pavarësinë e Tajvanit” dhe duke mos u përfshirë në një konflikt me Kinën.

Por këto deklarime e humbin rëndësinë dhe seriozitetin përballë lëvizjes së Uashingtonit, i cili vijon t'i sigurojë Tajvanit armë mbrojtëse, madje dhe Presidenti i SHBA Joe Biden ka thënë se SHBA do ta mbrojë Tajvanin ushtarakisht – duke thyer një qëndrim të njohur si paqartësi strategjike.

Ndaj këto zgjedhje duket se do të formësojnë rrjedhën e marrëdhënieve SHBA-Kinë – dhe do të ketë një ndikim të pashlyeshëm

në marrëdhëniet delikate midis SHBA-së, Kinës dhe Tajvanit.

Ministria e Jashtme kineze kundërshton deklaratën e SHBA-së për zgjedhjet në rajonin e Tajvanit

Sekretari amerikan i Shtetit Antony Blinken i dërgoi presidentit të sapozgjedhur Tajvanez William Lai një mesazh urimi pas rezultatit.

Pekini e quajti mesazhin shkelje të angazhimit të Uashingtonit për të mbajtur vetëm lidhje jozyrtare me Tajvanin.

“Ne mezi presim të punojmë me Dr Lai dhe udhëheqësit e Tajvanit të të gjitha palëve për të avancuar interesat dhe vlerat tona të përbashkëta”, tha ai në një deklaratë. Blinken theksoi gjithashtu se SHBA, një nga aleatët më të mëdhenj të Tajvanit, është “e përkushtuar për të ruajtur paqen dhe stabilitetin ndër ngushticat”.

Diplomati i lartë amerikan ishte gjithashtu i shpejtë për të thënë se një bashkëpunim i tillë duhet “të vazhdojë marrëdhënien tonë të gjatë jozyrtare” dhe të jetë “në përputhje me politikën e SHBA-së Një Kinë”.

Sipas politikës, SHBA njeh dhe ka lidhje formale me Kinën dhe jo me ishullin e Tajvanit, të cil-

in Kina e sheh si një provincë të shkëputur për t'u bashkuar me kontinentin një ditë.

Në një deklaratë, ministria e jashtme e Kinës tha se urimet e zotit Blinken shkelnin premtimin e SHBA-së për të mbajtur “vetëm marrëdhënie kulturore, tregtare dhe të tjera jozyrtare” me Tajvanin.

Pse zgjedhjet e 13 Janarit nuk janë një zgjidhje për Tajvanin?

Në prognozatat për rreziqet e mundshme globale për vitin 2024, zgjedhjet në Tajvan parashikoheshin që do të tronditnin ekuilibrat në kontinentin aziatik, madje me efekt global.

Ky vit po hyn në ujëra të turbullta gjeopolitike, rrymat e secilës na çojnë vrullshëm në Oqeanin Paqësor duke rrezikuar përplasjen e dy superfuqive si Kina dhe SHBA-ja.

Nga njëra anë janë Shtetet e Bashkuara, të cilët duken shumë të gatshëm për të mbështetur pavarësinë e Tajvanit dhe mbrojtjen e saj, pa kuptuar pasojat e mundshme politike dhe ekonomike. Nga ana tjetër është Kina, që kërkon të respektohet parimi i një Kinë, dhe mos ndërhyrja e në punët e brendshme të Pekinit.

Një përplasje e “titanëve” në Oqeanin Paqësor, do të fundoste jo vetëm ishullin e Tajvanit por do rrezikonte mbarë njerëzimin... ja pse është herët për të folur për fitoren e 13 Janarit!

Çdo përshkallëzim midis Kinës dhe Tajvanit rrezikon të kthehet në diçka më të madhe dhe më të rrezikshme. Ndeshja verbale theksoi ndarjen në dukje të pazgjidhshme mbi fatin e Tajvanit, një pikë e rëndësishme në marrëdhëniet SHBA-Kinë që rrezikon të çojë në një luftë në të ardhmen



Gjykata Kushtetuese miraton marrëveshjen e emigrantëve me Italinë

Marrëveshja mes Italisë dhe Shqipërisë për migrantët është në përputhje me Kushtetutën. Ky është vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që pritet të publikohet edhe zyrtarisht. Sipas lajmit të publikuar në media, Gjykata Kushtetuese në fund të shqyrtimit të kërkesës së 37 deputetëve të opozitës, ku kërkohet vlerësimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i marrëveshjes së nënshkruar nga Kryeministri Edi Rama dhe homologa e tij



italiane, Giorgia Meloni, vendosi rrëzimin e kërkesës.

Drafti për marrëveshjen për emigrantët, u miratua në Qeverinë italiane në 5 dhjetor dhe u

dërgua në parlamentin italian për miratim. Më 6 nëntor 2023 kryeministri Edi Rama dhe kryeministrja italiane Giorgia Meloni nënshkruan në Romë marrëveshjen për ndërtimin në Shqipëri të dy qendrave për strehimin e emigrantëve.

Sipas marrëveshjes porti i zbarkimit do të jetë Shëngjini, ndërsa Gjadri do të jetë kampi ku do të ndërtohet vendqëndrimi i tyre. Kapaciteti maksimal pritet të jetë 3 mijë shtretër.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë pret Ambasadoren e re të RP të Kinës në Shqipëri



Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë organizoi një drekë mirëseardhjeje me Ambasadoren e re të Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, Shkëlqesinë e Saj Pang Chuxue, në kuadër të fillimit të misionit të saj diplomatik.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë e uroi diplomaten e lartë kineze për fillimin e misionit në vendin tonë, duke i uruar suksese dhe punë të mbarë në forcimin e mëtejshëm të komunikimit midis dy vendeve.

Duke ju referuar miqësisë së hershme midis dy vendeve, u theksua se ekziston një bazë sol-

ide tradite dhe mirëkuptimi për shkëmbime më intensive dhe të institucionalizuara në fushën e ekonomisë, kulturës, turizmit si dhe në fusha të tjera me interes reciprok.

Shqipëria ka vlerësim të veçantë për arritjet në të gjitha fushat nga Republika Popullore e Kinës, dhe në vazhdim, ky vlerësim do të fitojë përmasa më të mëdha nëse diplomacia kineze lëviz me dashamirësi ndaj shtetit të Kosovës, duke bërë hapa praktikë që çojnë në njohjen e saj përfundimtare. Një rrugë efektive do të ishte në fillim njohja e

dokumenteve të Kosovës.

Shqiptarët janë një komb i shtrirë në disa shtete dhe ne ndjehemi si një e tërë mes vetes sonë dhe e konsiderojmë shumë të rëndësishëm kur edhe miqtë e partnerët tanë na vlerësojnë pa dallim pavarësisht kufijve gjeografikë.

Gjatë takimit u shkëmbyen mendime për çështje të rëndësishme të politikës së jashtme dhe veçanërisht të situatës në Ukrainë, si rrjedhojë e agresionit rus, mundësisë së arritjes së paqes atje dhe qëndrimit/rolit të Kinës, si një anëtar i përhershëm i KS të OKB-së.

MARRËDHËNIET SHQIPËRI-TURQI MES GJEOPOLITIKËS DHE FESË

Ministri i Jashtëm i Turqisë, Hakan Fidan javën e fundit të Janarit zhvilloi një tur ballkanik, ku vizitën e tij të parë e nisi nga Shqipëria e më pas në Bullgari dhe Rumani.

Që nga emërimi në postin e kryediplomatit nga presidenti turk Erdogan pas zgjedhjeve të vitit 2023, Hakan Fidan e ka vizitën e tij të parë jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Meqënëse ka shërbyer prej më shumë se 11 vitesh si shef i shërbimit sekret turk, ai shihet si një nga njerëzit e besuar të Erdogan dhe

që konsiderohet si pasues i tij. Kjo cilësohet si një vizitë e rangut më të lartë nga Turqia, ku ministri Hakan Fidan pati takime kokë më kokë me ministrin e Jashtëm, Igli Hasani, me presidentin Bajram Begaj, dhe kryeministrin, Edi Rama.

Megjithatë përpara zhvillimit të agjendës zyrtare të përcaktuar me krerët më të lartë të shtetit shqiptar, numri një i diplomacisë turke, nisi vizitën e tij në Tiranë pikërisht nga Xhamia e Namazgjasë, një xhami ende e painauguruar, statusi juridik i së cilës mbetet peng i një diskutimi të gjatë mes Shqipërisë dhe Turqisë. Çështja e inaugurimit të Xhamisë së Namazgjasë, e financuar nga shteti turk, ka mbetur pezull për shkak të akuzave për lidhje të komunitetit me FETO-n, organizata e shpallur terroriste nga Turqia, e cila ndjek ideologjinë e Fetullah Gulenit, armikut të përjetshëm të Erdogan, në ekzil prej vitesh në SHBA. Sipas Ankarasë, njerëzit e lidhur me këtë organizatë janë në krye të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Kjo është vënë re dhe nga fakti se ai nuk është shoqëruar prej asnjë figure të KMSH-së, nga asnjë figurë klerike muslimane në Shqipëri. Madje nga asnjë autoritet zyrtar shqiptar.

Është një vizitë gati diskrete në raport me median, pasi nuk pati asnjë njoftim zyrtar, ndonëse u përçuan simbolika të forta fetare me prezencën e tij

në këtë xhami, ku vetë Erdogan në vitin 2015 vendosi gurin e parë për ndërtimin e saj.

Ndërkohë, mesazhin e tij, ministri turk e tha gjatë një konference të përbashkët me homologun shqiptar Igli Hasani.

Ministri i Jashtëm turk Hakan Fidan, përmendi gjatë vizitës së tij në Tiranë atë që e quajti “pastrim i mbetjeve të fundit të organizatës FETO”, të klerikut Fetullah Gylen, të cilën Ankaraja e akuzon për veprimtari terroriste dhe si përgjegjëse të grushtit të dështuar të shtetit në vitin 2016.

Në deklaratën pas takimit të tij me homologun shqiptar Igli Hasani, kreu i diplomacisë turke u shpreh se kishte vënë në dukje “ndjeshmërinë që ka Turqia ndaj kësaj çështjeje dhe hapat që mund të hidhen konkretisht për këtë”. Duke diktuar edhe njehere veprimet që duhet të ndermarre Shqipëria.

Prej disa vitesh, thuhet të gjithë zyrtarët e lartë turq që kanë vizituar Tiranën, i kanë kërkuar autoriteteve shqiptare që të mos lejojnë të ashtuquajturit gylenistë, të mund të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në Shqipëri.

Dy vjet më parë Presidenti Tayyip Erdogan paralajmëroi se kjo çështje do të ishte përcaktuese në marrëdhëniet mes dy vendeve. Sipas Turqisë anëtarë të organizatës FETO veprojnë në fusha të ndryshme në Shqipëri, përfshirë dhe drejtimin e Komunitetit musliman shqiptar. Një element i cili ka bërë që të mbetet pezull dhe inaugurimi i xhamisë së Namazgjasë në Tiranë.

Përtej kësaj çështjeje, marrëdhëniet mes dy vendeve u vlerësuan nga të dyja palët, të jenë të një niveli mjaft të ngushtë. Edhe vetë fakti që Shqipëria është vendi i parë i një turi që parashikon vizita të ministrit të Jashtëm turk dhe në Rumani e Bullgari, shihet si një shenjë e rëndësisë që Ankaraja i jep raporteve me Tiranën. Nga ana tjetër, kryeministri Rama, njihet për raportin e tij të ngushtë me presidentin Er-



dogan, i cili ka qenë shpesh në qendër të kritikave për metodat e tij autoritariste në udhëheqjen e vendit të tij.

Shefi i diplomacisë turke, bëri po ashtu me dije se brenda 2024 do të zhvillojmë Këshillin e parë strategjik mes dy vendeve, marrëveshje e nënshkruar me kryeministrit Edi Rama dhe presidentit Recep Tayyip Erdogan në Anakara. Fidan shtoi se objektivi ekonomik është që niveli i fluksit tregtar mes Turqisë e Shqipërisë të kapë vlerën e 2 miliardë dollarëve brenda këtij viti.

Të dy vendet nënshkruan në janar të vitit 2021 Deklaratën e Partneritetit Strategjik, ndërsa marrëveshjet e firmosura mes dy vendeve, shtrihen në një reze të gjerë fushash të ndryshme, nga teknologjia, te transporti, energjia, mbrojtja, shëndetësia, turizmi, arsimiti, mjedisi si dhe kultura. Turqia, siç vuri në dukje dhe ministri i Jashtëm shqiptar Hasani është ndër investitorët më të mëdhenj në Shqipëri “me rreth 3.7 miliardë euro, ndërsa më shumë se 15 mijë shqiptarë janë të punësuar nga 830 kompanitë turke që operojnë në vendin tonë”.

Çfarë sjell kjo vizitë e top-diplomatit turk në Tiranë dhe Ballkan?

Kur flasim për marrëdhëniet Shqipëri-Turqi, është një marrëdhënie aq e fortë sa dhe e brishtë. Kjo pasi ndërthuret me zhvillimet gjeopolitike nga njëra anë dhe marrëdhëniet fetare nga ana tjetër. Kështu mund të percaktohet dhe kjo vizitë e top diplomatit turk në Tiranë, Bullgari e Rumani.

Në Shqipëri duket se përcaktimi gjeopolitik varet nga qasja religjioze.

Themi religjioze, fe-

tare nisur dhe nga fakti se vizitën e parë, Ministri i Jashtëm e zhvilloi në Xhaminë ende të painaguruar. Megjithatë, kjo vizitë simbolike në xhaminë e Namazgjasë, përcjell mesazh të fortë, duke marrë parasysh se së shpejti janë zgjedhjet e ardhshme të KMSH-së që do të zhvillohen në mars. Do të shihet nëse Turqia do influencojë pikërisht këto zgjedhje të cilat me pas duhet të konfirmojnë hapjen e Xhamisë së Namazgjasë, të financuar nga vetë Ankaraja. Sigurisht kjo vizitë e Hakan Fidan mund t'i shtrojë rrugën drejt një vizite të radhës të presidentit turk, Recep Tayyip Erdogan, në Shqipëri, por si duket jo përpara se të priten të gjitha fjetet e lidhjeve shqiptare me Fetullah Gulen.

Gjithashtu kjo vizitë ka rëndësi gjeopolitike rajonale nisur nga zhvillimet në Ballkan.

Kësisoj vizita e planifikuar në dy vende të Bashkimit Evropian, Bullgari dhe Rumani, ndikimin e Turqisë në skenën gjeopolitike rajonale.

Gjithshtu, Kosova dhe Armatimi i saj është pikë esenciale. Zhvillimet në Kosovë, përfshirë blerjen e dronit turk dhe armatimeve nga SHBA-të, reflektojnë ndikimin dhe ndërhyrjen e Turqisë në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke pasqyruar një lojë të kompleksuar gjeopolitike.

Prezenca e Turqisë shpreh ndikimin e thellë të Ankarasë në zhvillimet politike dhe gjeopolitike në rajonin e Ballkanit dhe jep një vështrim në përpjekjet për të arritur një pozicion strategjik në skenën globale.

Ndaj vizita e ministrit të Jashtëm turk në Tiranë, Sofje dhe Bukuresht, shfaq mundësinë e thellimit të bashkëpunimit dhe rolin e Turqisë në skenën gjeopolitike rajonale e cila padiskutim ndërthuret ngushtësisht mes influences fetare, ekonomike dhe asaj politike.



Çështja Beleri arrin në Parlamentin Evropian



Polemika e vazhdueshme midis Greqisë dhe Shqipërisë ka mbërritur në Parlamentin Evropian me arrestimin nga autoritetet shqiptare të një kryebashkiaku që i përket minoritetit grek të kombit.

Arrestimi i kryebashkiakut të Himarës Fredi Beleri erdhi në një debat mbrëmjen e 24 janarit, pas mbledhjes së Parlamentit të Komisionit të Punëve të Jashtme, teksa eurodeputetët diskutuan perspektivat e Shqipërisë për anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian.

“Ne duam vetëm të vendoset drejtësia”, tha Suela Janina, ambasadorja shqiptare e Bashkimit Evropian, për Bruksel Signal. Janina këmbënguli se qeveria shqiptare donte një gjykim të drejtë për Belerin.

“Ne do të shikojmë faktet dhe shpresojmë që rezultatet e çështjes të respektohen si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë Shqipërisë në Evropë.

Komentet e Janinës erdhën pasi

eurodeputetët dhanë mendime të përziera në lidhje me Shqipërinë. Eurodeputetja portugeze Isabel Santos, raportuesja e Parlamentit për Shqipërinë, tha se kombi ballkanik ka qenë “shembullor në procedurën e anëtarësimit”.

Vendi kishte bërë përparim në luftimin e krimit dhe korrupsionit dhe në përafrimin me politikën e jashtme të BE-së, tha ajo. Santos aludoi për tensionet e fundit, jo vetëm për Belerin, por edhe për vendosjen e Berishës në arrest shtëpie.

“[Këto] incidente ... i japin një goditje pranimit të Shqipërisë, ne nuk duhet të kemi frikë ta themi atë,” tha Santos.

Anna-Michelle Assimakopoulou, një eurodeputete për partinë qeverisëse të qendrës së djathtë të Greqisë Demokracia e Re, ishte kritike për çështjen Beleri. Duke pretenduar se seanca e tij ishte vonuar dhe se atij i ishte refuzuar leja për t’u larguar nga burgu për të folur në cilësinë e tij si kryebashkiak, Assimako-

poulou tha se çështja ishte më e madhe se sa një grindje e dy vendeve.

“Është një rast i respektimit të të drejtave të njeriut, nuk është një çështje dypalëshe mes Shqipërisë dhe Greqisë”, tha ajo.

“Nuk e them këtë sepse jam eurodeputete greke. Jo, kjo është një çështje evropiane, një çështje evropiane... e cila rëndon shumë në procesin e anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian.”

Në vazhden e pushtimit rus të Ukrainës, BE-ja po përshpejton zgjerimin pasi Brukseli dëshiron të mbrojë vendet fqinje nga ndikimi rus dhe kinez. Vende të tjera si Moldavia, Gjeorgjia dhe Ukraina kërkojnë mbrojtjen e BE-së nga Rusia.

Megjithatë, çështja Beleri mund të sjellë probleme për anëtarësimin e Shqipërisë në bllok, pasi Greqia thotë se mund të vërë veton ndaj anëtarësimit të vendit në BE nëse minoriteti grek i Shqipërisë “keqtrajtohet”.

Presidenca belge e BE-së në kriza dhe konflikte! Europës i mungon Delori! Tur i mirëpritur rajonal! Ftohtë jashtë, nxehtë brenda!!

REALPOLITIK FLASH NR. 83 | 2 - 19 JANAR 2024 | EKSKLUZIVISHT PËR ARGUMENTUM

Mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, me vetëm 1.000 fjalë nga analisti i njohur,



DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Presidenca belge e BE-së në kriza dhe konflikte në gjysmën e parë të vitit 2024. Vetë Belgjika do të ketë zgjedhjet bashkiake, rajonale dhe federale më 6 Qershor 2024, kur zhvillohen dhe zgjedhjet europiane, fushata e të cilave sapo ka filluar. Sfida më e madhe është neutralizimi i tentativave të së djathtës ekstreme për më shumë përfaqësim në forumin më të lartë të BE-së. Ajo është në pushtet në Itali, Slovaki, Fin-

landë, Holandë, dhe me trysni në rritje në Francë, Gjermani, Spanjë, etj.



Një nga kërkesat kryesore për shmangien e fuqizimit të ekstremit të djathtë është që brenda muajit Mars, në Samitin e BE-së të realizohet konsensusi i nevojshëm mbi Paktin e Mi-

grimit. Kjo mbasi azili i paligjshëm po i qëndron te koka si "Shpata e Demokleut" në 8 vitet e fundit BE-së. Madje, 2023 theu rekordin e vitit 2015 me mbi 1 milion azilantë të paligjshëm!

Paralelisht me zgjedhjet europiane do jetë dhe fushata paraprake e zgjedhjeve presidenciale amerikane, vendimtare për Europën dhe transatlantizmin në përgjithësi.

Dy kryesfidat e tjera më të mëdha janë vazhdimi i luftës midis Ruisë dhe Ukrainës që më 24 shkurt hyn në vitin e saj të tretë për të cilat ARGUMENTUM ka shkruar shumë, ndaj nuk po ndalemi më tej këtu.

Sfida tjetër madhore është në Lindjen e Mesme, në vijim të përshkallëzimit të gjendjes pas sulmit terrorist të Hamasit kundër Izraelit më 7 Tetor 2023. Çështja këtu shtrohet që të forcohet roli gjeopolitik i BE-së, mbasi deri tani, ka qenë më tepër spektatore në atë rajon dhe donatore ndihmash. Mirëpo gjendja dhe rebusi politik atje është tejet i ngatërruar dhe shpërthyes; ai nuk lejon qoftë dhe një arpushim të vogël, le më pastaj paqe të qëndrueshme sipas projektit me dy shtete.

Dy kryesfidat e tjera i takojnë Ballkanit Perendimor si rajon dhe secilit vend në të. Këtu spikat problemi i mbetur i dialogut midis Serbisë dhe Kosovës, sidomos i Marrëveshjes së Brukselit dhe Ohrit e deri te asociacioni i komunave me shumicë serbe dhe aspektet e tjera ta debatueshme. Mirëpo, praktikisht, duke qenë se dhe ndërmjetësuesit perendimorë “kanë dalë jashtë loje sepse realisht u ka dalë boja” pavarësisht nga eufemizmat diplomatike nuk pritet ndonjë arritje. Presidencës belge, megjithë predispozicionin e përherëshëm dhe traditën e saj pozitive të mbështetjes pa rezerva të rajonit i mbetet vetëm të zbatojë



Jacques Delors

parimin ” tërhiq e mos e këput” derisa të zgjidhen liderшипet e reja në BE dhe në SHBA në fund të vitit.

As lidhur me zgjerimin e BE-së drejt Ballkanit Perendimor nuk pritet gjë; për rastin tonë kërkohet detyrimisht zgjidhja e Çështjes Beleri, ndryshe në kalendat greke.

Megjithatë, ka vend për optimizëm të moderuar, kur mendon se Belgjika i ka mundësitë, traditat, përvojën dhe kapacitetet për t’i përballuar këto sfida madhore.

Kështu, në 4 dekadat e fundit, kryeministrat e saj të mirënjohur, i ndjeri Wilfried Martens dhe Luc de Haene, deri te ai më i

riu, Guy Verhofstadt kanë qenë përkatësisht president i Partive Popullore Europiane, Nënkrjetar i Komisionit Kushtetues të BE-së dhe Kryetar i Grupit Liberal në Parlamentin European, ky i fundit deri në ditët e sotme; Ish Kryeministri Herman van Rompuy ishte President i Këshillit European gjatë periudhës 2009 – 2014, ndërsa Charles Michel gjatë periudhës 2019 e në vazhdim.

2.

BE-së i mungon Delori! Kjo mungesë ndihet më shumë mbas 5 janarit kur iu dha lamtumira e fundit ish europianistit emblematic, Jacques Delors. Pa dyshim Presidenti më i madh i Komisionit (1984 – 1994) Kjo falë personalitetit, integritetit absolut dhe vizionit të tij, çka bënë të mundur që Europa në ato vite vendimtare të realizonte disa arritje vërtet madhështore dhe t’i çelte rrugën sukseseve dhe më të bujshme. Delors ishte në krye

Dy kryesfidat e tjera i takojnë Ballkanit Perendimor si rajon dhe secilit vend në të. Këtu spikat problemi i mbetur i dialogut midis Serbisë dhe Kosovës, sidomos i Marrëveshjes së Brukselit dhe Ohrit e deri te asociacioni i komunave me shumicë serbe dhe aspektet e tjera ta debatueshme. Mirëpo, praktikisht, duke qenë se dhe ndërmjetësuesit perendimorë “kanë dalë jashtë loje sepse realisht u ka dalë boja” pavarësisht nga eufemizmat diplomatike nuk pritet ndonjë arritje.

kur BE-ja realizoi Shengenin historik më 1985, Tregun Unik më 1986, përgatitja e bazave të Euros, shembja e komunizmit në Europën Qendrore dhe Lindore, fillimin e procesit të zgjerimit nga ish lindja, Traktati i Maastrichtit më 1992 e të tjera. Ky socialist i shquar francez iu imponua me logjikën, autoritetin dhe fuqinë e butë të gjitha instancave të tjera të BE-së. Asnjë tjetër përpara dhe mbas tij nuk ka arritur në ato lartësi; kjo sepse tanimë pavarësisht fjalëve të bukura dhe premtimeve, emisarët e lartë të BE-së janë më shumë produkte llogaritjesh dhe pazaresh politike, pa ndonjë vizion dhe fuqi të butë.



Ministri i Jashtëm, Igli Hasani

